

VENDIM
Nr.17, datë 13.1.2006

**PËR MIRATIMIN E AFATEVE TË PËRDORIMIT TË ARMËVE, TË TEKNIKËS E
TË PAJISJEVE TË FORCAVE TË ARMATOSURA DHE TË RREGULLAVE PËR
TRAJTIMIN E TYRE PAS HEQJES NGA ARMATIMI DHE PËRDORIMI**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikave 7 e 11 të nenit 14 të ligjit nr.8671, datë 26.10.2000 “Për pushtetet dhe autoritetet e komandimit e të drejtimit strategjik të Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, me propozimn e Ministrit të Mbrojtjes, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Miratimin e afateve të përdorimit të armëve, mjeteve dhe pajisjeve të Forcave të Armatosura, sipas tabelave nr.1 dhe nr.2 që i bashkëlidhen këtij vendimi.
2. Në Forcat e Armatosura, arma, mjeti ose pajisja të hiqen nga përdorimi me urdhër të autoritetit përkatës sipas pikës 5 të këtij vendimi, kur janë plotësuar:
 - a) vitet e përdorimit, sipas tabelave nr.1 e nr.2;
 - b) kilometrat e përshkruara, sipas tabelës nr.1;
 - c) orët e punës të kryera, sipas tabelës nr.1;
 - ç) numri i të shtënave, të kryera sipas tabelës nr.2.
3. Të gjitha mjetet, pajisjet dhe armatimi, që hiqen nga përdorimi në Forcat e Armatosura, por që kanë vlera përdoruese në gjendjen që janë, lejohen të shiten, sipas legjislacionit në fuqi.
4. Mjetet, pajisjet dhe armatimi, që hiqen nga përdorimi në forcat e Armatosura, por që nuk mund të shiten si mjete dhe pajisje ushtarake, lejohen t’u nënshtrohen procedurave të asgjësimit, demilitarizimit dhe tjetërsimit të pronës shtetërore.
5. Procedurat dhe përgjegjësitë për heqjen nga përdorimi të armëve, mjeteve dhe pajisjeve të Forcave të Armatosura janë si më poshtë vijon:
 - a) Për anijet, avionët, helikopterët dhe raketat tokë-ajër, propozimi për heqjen nga përdorimi të bëhet nga Ministri i Mbrojtjes dhe të miratohet nga Kryeministri;
 - b) Për armatimin, raketat portative dhe municionet luftarake, mjetet e blinduara, mjetet e transportit dhe sistemet e pajisjet e ndërlihdjes, propozimi për heqjen nga përdorimi të bëhet nga Shefi i Shtabit të Përgjithshëm të Forcave të Armatosura dhe të miratohet nga Ministri i Mbrojtjes;
 - c) Për pajisjet fushore, makineritë dhe pajisjet e mirëmbajtjes, të komunikimit telefonik, kompjuterike dhe të shëndetësisë, propozimi për heqjen nga përdorimi të bëhet nga komandanti i forcës ose i komandës mbështetëse përkatëse dhe të miratohet nga Shefi i Shtabit të Përgjithshëm të Forcave të Armatosura.
 - ç) Për burimet e ushqimit elektrik të ndërlihdjes dhe për të gjitha pajisjet e tjera, që nuk përfshihen në shkronjat “a”, “b”, e “c”, propozimi për heqjen nga përdorimi të bëhet nga komandantët e brigadave/regjimenteve dhe të miratohet nga komandanti i forcës ose i komandës mbështetëse përkatëse.
6. Ministri i Mbrojtjes të paraqesë për miratim në Këshillin e Ministrave afatet e përdorimit për armët, mjetet dhe pajisjet, që përdoren nga Forcat e Armatosura, për të cilat nuk janë miratuar afate përdorimi në tabelat që i bashkëlidhen këtij vendimi.
7. Vendimi nr.617, datë 4.12.2002 i Këshillit të Ministrave “Për heqjen nga armatimi dhe përdorimi të një pjese të armëve, teknikës dhe pajisjeve të Forcave të Armatosura dhe për asgjësimin ose çmontimin dhe shitjen e tyre”, i ndryshuar, zbatohet vetëm për mjetet dhe pajisjet ushtarake, që janë hequr nga përdorimi, sipas tabelave që i bashkëlidhen vendimit të

mësipërm.

8. Të ardhurat, që do të realizohen sipas pikës 3 të këtij vendimi, të ndahen përkatësisht:

- 10 për qind Buxhetit të Shtetit;

- 90 për qind Ministrisë së Mbrojtjes, për t'u përdorur për nevojat e modernizimit dhe të ristrukturimit të Forcave të Armatosura.

9. Ngarkohet Ministria e Mbrojtjes të nxjerrë udhëzimin përkatës për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI

Sali Berisha